

LIGJ
Nr.8276, datë 14.1.1998

PËR VARËSINË E KAPITENERISË SË PORTEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Kapiteneritë e porteve kalojnë në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transporteve.

Neni 2

Shfuqizohet dekreti nr.16, datë 9.8.1991 “Për disa ndryshime në dekretin nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, dhe në dekretin nr.4938, datë 4.2.1972 “Për kapiteneritë e porteve””.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1991, datë 21.1. 1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani